



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:067033

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830714

P.nr.784/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe bashkëpunëtori profesional Bekim Telaku, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh.B., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5842/21 të datës 04.04.2022, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 13.06.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Valdrin Krasniqi dhe të pandehurit Xh.B, me datë 14.06.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 18.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

Xh.B nga babai F. dhe nëna B., mbiemri i vajzërisë se nënës K., i lindur me datë ..., në Prishtinë, ku edhe banon, rruga "...", nr., lagja "...", i martuar, baba i tre fëmijëve, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, ka te kryer shkollimin universitar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 22.07.2021, rreth orës 23:10 në Prishtinë, në rrugën "Bajram Bahtiri", dhe rrugës "Llapi", i pandehuri Xh.B., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, ashtu që pas një kontrolli nga ana e policisë tek i njëjti është gjetur substancë narkotike kokainë me peshë prej 0.3 gram, për të cilën pas ekzaminimit është vërtetuar se është substancë narkotike e llojit kokainë.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.1, 40 par. 1 pika 1.3, 43, 69, 70, nenit 269 par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, si dhe 449 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 800 € (treqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet të paguaj gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Në mbështetje të nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, **URDHËROHET KONFISKIMI** i përhershëm i sendit dhe atë: substanca narkotike e llojit kokainë në peshë prej 0.3 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

I pandehuri obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € (njëzet euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP.II.nr.5842/21 të datës 04.04.2022 të pandehurin Xh.B., e ka akuzuar për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 13.06.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ish-in Prokurori i Shtetit Valdrin Krasniqi dhe i pandehuri Xh.B.

Gjyqtari i vetëm gjykuese e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat konform nenit 241 par. 1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtit i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri pas sqarimeve të nevojshme nga ana e gjykatës deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar i vjen keq për atë çka ka ndodhur, kërkon falje, i premtonte gjykatës se nuk do të kryej veprime të tilla apo të ngjashme në të ardhmen dhe se tani nuk është konsumues i narkotikëve.

Pasi që i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, i cili ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase është në pajtim të plotë me nenin 242 të KPRK-ës, dhe po ashtu është në harmoni me provat që gjenden

në shkresat e lëndës, me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, i ka propozuar gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë. Ndërkaq me rastin e shqiptimit të dënimit, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh shkalla e përgjegjësisë penale, si dhe sjellja e mëparshme e të pandehurit, të vlerësohet nëse edhe më parë a ka qenë i dënuar për vepra të tilla penale.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, dhe po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykyese u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së

Me qenë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin me gjobë, i cili dënim është i përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, parapraakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimin të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i pandehuri për veprën penale për të cilën akuzohet, shprehjen e keqardhjes për kryerjen e veprës penale, bashkëpunimin e tij me gjykatën dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën përgjegjësisë penale të pandehurit dhe peshën e veprës penale duke pasur parasysh edhe llojin e substancë narkotike të cilën e ka poseduar i pandehuri.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Gjykata përkitazi me dënimin

me gjobë mori për bazë pranimin e fajësisë, kërkim faljen e të pandehurit dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla. Gjykata me këtë dënim konsideron se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbejë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbajë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi konfiskim

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit ka urdhëruar edhe konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, më afër të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për faktin se i pandehuri nuk ka pasur autorizim për posedimin e narkotikut. Në anën tjetër, substanca narkotike e cekur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike, andaj nga këto arsye gjykata ka vendosur ta konfiskoj përherë dhe substanca narkotike si e tillë ka urdhëruar që të shkatërrohet. Andaj, gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet dhe kërkesat ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike sipas nenit 269 par.3 KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm të sendeve të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro). Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.784/22 datë 18.06.2024

Bashkëpunëtor Profesional
Bekim Telaku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.